

D E K R E T
Nr.758, datë 1.2.1994

PËR NJË MBROJTJE TË VEÇANTË TË USHTARAKUT

Në mbështetje të nenit 28, pika 19, të ligjit nr.7491, datë 29.4.1991 “Për dispozitat kryesore kushtetuese”,

D E K R E T O J :

Neni 1

Në nenin 31 të Kodit Penal, pas pikës “dh” si rrethanë rënduese, shtohet pika “e” me këtë përmbajtje:

e) kryerja e veprës penale ndaj ushtarakut për shkak të detyrës së tij.

Neni 2

Në nenin 81 të Kodit Penal, pas pikës “e” shtohet pika “ë” me këtë përmbajtje:

ë) ndaj një ushtaku për shkak të detyrës së tij.

Neni 3

Kur ushtaraku për shkak të detyrës e si rrjedhojë e veprimeve të dhunshme ndaj tij, humbet jetën, pjesëtarët e familjes përfitojnë pension familjar në masën 100 për qind të pagës mujore të muajit të fundit kalendarik të shërbimit, pavarësisht nga periudha e sigurimit të të ndjerit.

Pjesëtarët e familjes dhe kushtet në të cilat ata e përfitojnë këtë pension, janë ata të përcaktuar në nenin 40, pika 2 dhe 3, të ligjit nr.7703, datë 11.5.1993.

Pjesëtarët e familjes që gëzojnë një pension tjetër, kanë të drejtë të zgjedhin njërin, më të favorshmin.

Pensioni familjar jepet në emër të njërit nga përfituesit, sipas radhës së përcaktuar në nenin 40, pika 2, të ligjit nr.7703, datë 11.5.1993. Në rastet kur për shkaqe të ndryshme, lind nevoja e ndarjes së pensionit familjar ndërmjet përfituesve, masa konkrete për secilën caktohet me vendim të Gjykatës. Në këto raste fëmijët përfitojnë jo më pak se 50 për qind të shumës së pensionit familjar.

Neni 4

Në rastet e përcaktuara në paragrafin e parë të nenit 3, jepet një shpërblim i menjëhershëm në masën deri në 5 paga bazë mujore të ushtarakut oficer në funksionin me të ulët të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë.

Neni 5

Kur ushtaraku për shkak të detyrës e si rrjedhojë e veprimeve të dhunshme ndaj tij humbet pjesërisht ose tërësisht aftësinë për punë e shërbim, për kohën e paaftësisë paguhet në masën 100 për qind të pagës mujore të muajit të fundit kalendarik.

Kur ushtaraku për shkak të aftësive të kufizuara caktohet në një punë a detyrë që paguhet më pak, deri në kohën e riaftësimit të plotë përfiton kompensimin e pagës mujore që kishte.

Në rastet e paragrafit të parë dhe kur paaftësia zgjat më shumë se 10 ditë, ushtarakut i jepet një ndihmë e menjëhershme në masën deri në një pagë bazë mujore të ushtarakut oficer në funksionin më të ulët të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë.

Neni 6

Fëmijëve, të ushtarakëve që kanë humbur jetën për shkak të detyrës si rrjedhojë e veprimeve

të dhunshme ndaj tyre, kur ata fitojnë të drejtën e ndjekjes së arsimit të lartë, shteti u garanton bursë.

Neni 7

Ngarkohet Këshilli i Ministrave për zbatimin e neneve të këtij dekreti që sjellin efekte financiare.

Neni 8

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë dhe do të zbatohet për të gjithë ushtarakët që kanë humbur jetën, për shkak të detyrës si pasojë e veprimeve të dhunshme ndaj tyre, pas datës 3.7.1991.

KUNDËRFIRMOHET
KRYEMINISTRI
Aleksandër Meksi

PRESIDENTI I REPUBLIKËS
Sali Berisha

Miraturar me ligjin nr.7799, datë 24.2.1994 të Kuvendit Popullor.